



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:130254  
Datë: 04.04.2024  
Numri i dokumentit: 05542133

**PAKR.nr.604/2023**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** - Departamenti për të Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Kadrije Goga Lubishtani, kryetare e kolegjit, Hashim Çollaku dhe Xhevdet Abazi, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Endrit Ajeti, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit L.Sh., nga Prishtina, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psiko trope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit L.Sh., av.Ali Ajeti, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.949/2020, të dt.28.08.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.20.03.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit L.Sh., av.Ali Ajeti, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.949/2020, të dt.28.08.2023, **vërtetohet**.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.949/2020, të dt.28.08.2023, është shpallur fajtor i akuzuari L.Sh., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psiko trope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve, si dhe dënimi me gjobë në shumën prej 1.000 (njëmijë) Euro, të

cilat dënime do të ekzekutohen në afat prej 15 ditëve, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet, atëherë i njëjti do ti zëvendësohet në dënimin me burgim, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 20 Euro.

Në kuptim të nenit 267 par.5 të KPK, lidhur me nenin 276 par.1 dhe 2, pika 2.2 të KPK, konfiskohet: substanca narkotike e llojit marihuan, me peshë të përgjithshme 10.23gr, ashtu që urdhërohet Policia e Kosovës, Njësitit DHTN-DKKO, në Prishtinë, që pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të bëjë asgjësimin e substancës narkotike.

Është obliguar i akuzuari L.Sh., që të paguaj shpenzimet e procedurës penale sado që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, paushallin gjyqësor në shumën prej 50 Euro, si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit, shumën prej 50 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor, ankesë ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit L.Sh., av.Ali Ajeti, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, të ndryshohet ashtu që i akuzuari të lirohet nga akuza, ose që të ndryshohet dhe të bëhet ri cilësimi juridik i veprës penale, nga neni 267 në nenin 269 të KPK, dhe të shpallet fajtor për të njëjtën, për posedim të narkotikut.

Po ashtu si opsion propozojmë që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe çështja penale ti kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim e vendosje.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me shkresën PPA/I.nr.547/2023, të datës 18.10.2023, duke u sqaruar përkritazi me ankesën e mbrojtësit së të akuzuarit L.Sh., av.Ali Ajeti, ka propozuar që e njëjta të refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.949/2020, të dt.28.08.2023, të vërtetohet.

Në kuptim të nenit 390 të KPPK, kolegji i kësaj gjykate ka caktuar dhe mbajtur seancën e kolegjit me dt.20.03.2024, dhe i ka njoftuar në mënyrë të rregullt të gjitha palët nga shkresat e lëndës.

Në seancë të kolegjit kanë prezantuar, i akuzuari L.Sh., si dhe mbrojtësi i tij, av.Ali Ajeti.

Nuk ka prezantuar Prokurori i Apelit, përkundër asaj që është njoftuar me rregull.

Mbrojtësi i të akuzuarit L.Sh., av.Ali Ajeti, ka deklaruar se ngel në tërësi pranë ankesës së ushtruar me shkrim, duke shtuar se gjykata gabimisht ka vlerësuar gjendjen faktike, sepse kemi kualifikim të gabuar të veprës penale, ngase i akuzuari është vetëm përdorues i substancave narkotike, por në asnjë mënyrë nuk është vërtetuar se i njëjti është shitës i këtyre substancave.

Gjithashtu ne kemi propozuar që të caktohet një ekspert për vlerësimin e gjendjes shëndetësore në aspektin mendor të akuzuarit, mirëpo e njëjta është refuzuar pa ndonjë arsye, andaj në mungesë të aprovimit të propozimit tonë, propozojmë që çështja penale të anulohet dhe ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim e vendosje apo që i njëjti të lirohet nga akuza në mungesë të provave, se ka krye veprën penale për të cilën është akuzuar.

I akuzuari L.Sh., deklaroi se e mbështet ankesën e ushtruar, nga ana e mbrojtësit të tij, av.Ali Ajeti, si dhe paraqitjen e tij në seancë të kolegjit.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenin 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, nga ana e mbrojtësit së të akuzuarit L.Sh., av.Ali Ajeti, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

**Ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit L.Sh., av.Ali Ajeti, nuk është e bazuar.**

Sipas ankesës së të mbrojtësit së të akuzuarit L.Sh., av.Ali Ajeti, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat konsistojnë në kuptim të nenit 384 par.1 nën par.1.12 dhe 1.8 të KPPK, sepse dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i pa kuptueshëm, i pa qartë dhe kundërthënës në brendinë e tij, si dhe arsyet e dhëna në raport me të akuzuarit L.Sh..

Për më tepër dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me vetveten dhe me arsyet e paraqitura në raport me të akuzuarin L.Sh., e po ashtu nuk janë paraqitur arsyet tjera me faktet vendimtare, kurse ato që janë paraqitur janë të pa qarta dhe kundërthënëse, dhe jo të sakta, të cilat gjykata e shkallës së parë, i ka marrë parasysh përkundër asaj që është dashur që ti ketë si pjesë përbërëse të punës. Në shqyrtimin gjyqësor, janë proceduar provat, dhe procesverbalet që janë pjesë përbërëse e punës, të cilat vlerësohen për ekzistimin e veprës penale, dhe përgjegjësisë penale, gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar të njëjtët në masë të duhur për të vërtetuar ekzistimin e veprës penale. Nga kjo rezulton se në veprimet e të akuzuarit L.Sh., nuk janë formuluar elementet inkriminuese të veprës penale, blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psiko trope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPK, por elementet e ndonjë vepra tjetër penale, për të cilat është dashur që të vlerëson gjykata e shkallës së parë, sikurse është vepra penale posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psiko trope dhe analoge nga neni 269 par.1 të KPK, ashtu që aktgjykimi pasi që përfshihet me shkeljet esenciale sepse nuk janë vlerësuar elementet inkriminuese se për cilën vepër penale, i akuzuari duhet të akuzohet, e njëjta si e tillë nuk mund të qëndroj dhe aktgjykimi duhet të anulohet.

Po ashtu është dashur që të vlerësohet se i akuzuari ka çrregullim mendor, depression, me diagnozën F-12.5ICD10, dhe është trajtuar në Institutin e Forenzikës Psikiatrike në Shërbimin Spitalor në QKUK në Prishtinë, ashtu që në këtë çështje penale apo nëse vlerësohet raporti mjekësor sikurse parasheh dispozita mjekësore, nga neni 133 KPPK, atëherë edhe është dashur që ti nënshtrohet një ekzaminimi psikiatrik, për të vërtetuar gjendjen shëndetësore të akuzuarit.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së ushtruar nga ana e mbrojtësit së të akuzuarit L.Sh., av.Ali Ajeti, si dhe shkresat e tjera të lëndës dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, të parapara nga neni 384 i KPPK, për të cilat shkelje përkujdeset edhe sipas detyrës zyrtare, nga neni 394 të KPPK.

Kolegji ka ardhur në përfundim se dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë, i kuptueshëm, në harmoni me vetveten, si dhe me pjesë tjera të aktgjykimit, ngase përmban arsyet lidhur me faktet vendimtare të cilat e karakterizonin veprën penale, blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psiko trope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPK, sepse gjykata e shkallës së parë, është përkujdesur në mënyrë të qartë që të vërtetoj elementet inkriminuese të kësaj vepre, për të cilën i akuzuari është akuzuar. Po ashtu nga shkresat e lëndës rezultojnë se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar që në veprimet e të akuzuarit qëndrojnë elementet e veprës penale të përshkruara më lartë, e cila rezultojnë nga të gjitha shkresat e lëndës, sikurse janë provat personale, po ashtu edhe ato materiale. Gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar të gjitha veprimet gjatë të gjitha fazave të procedurës, dhe ka ardhur në përfundim që të njëjtat janë vlerësuar në mënyrë të qartë dhe të plotë, sipas dispozitave ligjore nga neni 7 të KPPK, sepse që të gjitha institucionet të cilat kanë zhvilluar procedurë kanë përmbushur detyrimin e përgjithshëm për vërtetimin e plotë dhe të saktë të fakteve, dhe se saktësisht kanë paraqitur vërtetimin e elementeve të veprës penale, ashtu që në kuptim të nenit 364 të KPPK, me rastin e marrjes së aktgjykimit dënues, ka vërtetuar veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari, së bashku me faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse të KPK.

Po ashtu gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye për çdo pikë të aktgjykimit, andaj aktgjykimi është hartuar në pajtim me dispozitën ligjore nga neni 369 i KPPK, sepse për çdo pikë të aktgjykimit janë paraqitur arsye të qarta dhe të sakta, si dhe gjykata e shkallës së parë, ka paraqitur në mënyrë të qartë saktësinë e secilës provë, e cila ka qenë domethënëse për të vendosur çështjen penale. Gjatë vlerësimit të aktgjykimit, kolegji ka ardhur në përfundim se nga ana e gjykatës së shkallës së parë, janë dhënë arsyet për mos miratimin e ndonjë propozimi nga ana e mbrojtësit së të akuzuarit sepse të njëjtat propozime kanë qenë të artikuluara më herët, ashtu që në rastin konkret duke pasur parasysh që i akuzuari L.Sh., është konsumues i substancave narkotike – marihuan, afër tij është gjetur një qese plastike me tetë paketime, që nënkupton se kanë qenë të destinuar për tu shpërndarë dhe se i njëjti ka qenë ditën kritike në shoqëri me Dardan Krasniqi, i cili ka pohuar se ka thith njëherë cigaren e mbështjellë të cilën e ka konsumuar, këtu i akuzuari.

Pasi që janë formuluar elementet qenësore të veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor, kolegji ka ardhur në përfundim se me këtë çështje penale, nuk janë bërë shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, andaj aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, e ka mbështetur e duhur ligjore.

Për shkak të shkeljeve të ligjit penal, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar nga ana e mbrojtësit së të akuzuarit L.Sh., av.Ali Ajeti, duke pretenduar se në veprimet e të akuzuarit nuk janë formuluar elementet qenësore të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psiko trope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPK, ngase dispozitivi nuk bënë përshkrimin e asnjë veprimi për të gjitha elementet ekzistuese të kësaj vepre penale dhe se nuk është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit, janë manifestuar këto elemente që kanë pasur për qëllim shitjen dhe shpërndarjen e substancave narkotike, por vetëm ka qenë e njëjta për përdorim, kështu që janë formuluar elementet e veprës penale, nga neni 269 par.1 të KPK.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së ushtuar përkitazi me shkeljet e ligjit penal, dhe ka ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë, gjatë mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, në mënyrë të pa dyshimtë, ka vërtetuar pasi që ka proceduar dhe vlerësuar të gjitha provat personale dhe materiale se i akuzuari L.Sh., ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psiko trope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPK, e kjo është vlerësuar pasi që i akuzuari është shpallur fajtor dhe është nxjerr aktgjykim dënues në kuptim të nenit 364 të KPPK. Duke vlerësuar si tërësi aktgjykimin e ankimuar, kolegji vije në përfundim se me aktgjykimin e nxjerrë nuk janë manifestuar elementet e shkeljes se ligjit penal, të paraparë në nenin 385 të KPK, sepse vepra penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor është e paraparë me ligjin e aplikueshëm penal, se nuk ka gjetur arsye të cilat e përjashtojnë të akuzuarin nga ndjekja penale, si dhe përgjegjësia penale, se gjatë marrjes së vendimit për dënimin, dënimin plotësues, gjykata e shkallës së parë, gjykata e shkallës së parë, ka vepruar në kuadër të kompetencës ligjore, andaj aktgjykimi nuk përfshihet me shkeljet e pretenduara.

Edhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, mbrojtësi i të akuzuarit L.Sh., av.Ali Ajeti, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, e ka ankimuar duke theksuar se nuk janë vlerësuar në mënyrë të drejtë të gjitha provat, ngase gjykata e shkallës së parë, me mos vlerësimin e tërësisht të provave, ka nxjerrë aktgjykim jo të qëndrueshëm, sepse nuk e ka vërtetuar gjendjen faktike. Nga të gjitha provat e proceduara dhe vlerësuara, është konstatuar se ditën kritike i akuzuari ka qenë duke qëndruar në lagjen Ulpiana, se është takuar me shokun e tij, mirëpo, me asnjë nga provat e administruara, nuk është vërtetuar se i akuzuari ka vu për shitje apo shpërndarje sasinë e substancës narkotike, prej 10.23gr, përkundër asaj se në largësi prej 2m, ka pasur tetë qese të plastikës. Gjykata është dashur që të vërtetoj këtë rrethanë dhe të vërtetoj se i akuzuari edhe më parë ka qenë konsumues i substancave narkotike, andaj në vlerësim të të gjithë këtyre rrethanave është dashur ta bëjë riciklimin juridik të veprës penale nga neni 267par.1 nga neni 269 par.1 të KPK, dhe të akuzuarit ti shqipton dënim sa më të butë. Kjo vije në shprehje ngase te i njëjti gjendja psikike nuk është e plotë sepse ka çrregullime mendore – depresion DG.F.12.5 ICD10, e të cilat gjykata e shkallës së parë nuk i ka marrë parasysh e po ashtu është dashur që të ketë parasysh sasinë e substancës narkotike e cila ka qenë relativisht e vogël.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, përkitazi me gjendjen faktike dhe ka ardhur në përfundim se njëjta është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, nga ana e gjykatës së shkallës së parë, ngase me të gjitha provat materiale dhe personale,

me të cilat gjykata i ka proceduar dhe vlerësuar, në mënyrë të pa dyshimtë është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit janë formuluar elementet qenësore të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psiko trope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPK. Po ashtu në bazë të deklaratave të cilat gjykata e shkallës së parë i ka proceduar, nisur nga vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve, raporti i testit laboratorik, foto dokumentacioni nga shkresat e lëndës, duke vërtetuar se ditën kritike është gjetur i akuzuari L.Sh., që pa autorizim ka poseduar substancë narkotike, dhe se te i njëjti pas kontrollimit sipërfaqësor në trup janë gjetur tetë qese dhe një cigare të mbushura me substancë narkotike të llojit marihuan, që të gjitha në peshë prej 10.23gr. Kjo sasi e substancës narkotike është vërtetuar nga raporti i testit laboratorik i dt.16.10.2020, dhe marrjes së mostrave nga dëshmia EX-1, sipas pajisjes laboratorit Narttest NTX2000, që ka rezultuar si pozitive dhe e cilësuar si substancë narkotike e llojit marihuan. Po ashtu gjykata e shkallës së parë, ka proceduar edhe me fletë lëshimin e lëshuar nga QKU e Kosovës, Klinika e Psikiatrisë, me nr.836/69, e dt.25.02.2015, është vërtetuar se pas ekzaminimit të pacientit i akuzuari është diagnostikuar me diagnozën çrregullim mendor si pasoje e përdorimit kanabioditeve, F-12.5 (ICD10). Pasi që janë proceduar të gjitha provat, atëherë në kuptim të nenit 344 par.1 të KPPK, pasi që i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë në mbrojtjen e tij ka theksuar e ngel në tërësi pranë të dhënave në procedurë paraprake, gjykata e shkallës së parë ka procedurë edhe me prova të tjera, ashtu që në cilësi të dëshmitarit është dëgjuar D.A., - zyrtar policor, ka deklaruar se nuk kemi gjetur substanca narkotike te i akuzuari, por kemi gjetur afër tij, një qese të zezë me tetë paketime, e të cilat pasi që janë nënshtruar ekzaminimit, është konstatuar se kanë qenë marihuan. Po ashtu edhe dëshmitari Dardan Krasniqi, ka theksuar se është e vërtetë që mua më ka dhënë narkotik, kurse veprime të tjera nuk di që ka ndërmarrë L.. Që të gjitha këto prova sikurse personale dhe ato materiale, në mënyrë të pa dyshimtë vërtetojnë se në veprimet e të akuzuarit, janë formuluar elementet qenësore të veprës penale, nga neni 267 par.1 të KPK, sepse vet paketimet – në tetë qese, qojnë në drejtim të asaj që destinacioni ka qenë shpërndarja, andaj gjykata e shkallës së parë, pasi që i ka vlerësuar që të gjithë në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, kur të akuzuarin e ka shpallur fajtor dhe i ka shqiptuar dënimin përkatës ligjor.

Edhe për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, është ankimuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit L.Sh., av.Ali Ajeti, duke theksuar se në këtë çështje penale pasi që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë përfshihet me shkeljet e theksuara më lartë, e sidomos ato të ligjit penal, edhe vendimi për dënimin, nuk është i drejtë, sepse në veprimet e të akuzuarit ka elemente të veprës penale nga neni 269 par.1 të KPK, e jo për shkak të veprës penale nga neni 267 par.1 të KPK. Si rezultat i shkeljeve të theksuara në ankesë, propozojmë që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe ti kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim e vendosje.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së ushtruar nga ana e mbrojtësit së të akuzuarit L.Sh., av.Ali Ajeti, dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, e cila rezulton se është vërtetuar pasi që janë vërtetuar dhe vlerësuar të gjitha provat nga shkresat e lëndës, sikurse ato materiale dhe ato personale, ashtu që gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave rënduese dhe

lehtësuese të parapara në nenin 69 dhe 70 të KPK, kurse si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar moshën relativisht të re të akuzuarit, kurse si rrethanë rënduese ka vlerësuar mënyrën e kryerjes së veprës penale, si dhe shkallën e intensitetit të kryerjes së të njëjtit.

Duke pasur parasysh të gjitha këto rrethana, e pasi që nga ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit nuk ka gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese, kolegji i kësaj gjykate ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij, që të parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të paraparë në nenin 38 të KPK-së.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.nr.604/2023, të datës 20.03.2024**

**Procesmbajtës,**  
**Endrit Ajeti**

**Anëtarët e kolegjit,**  
**Hashim Çollaku**

**Kryetare e kolegjit,**  
**Kadrije Goga Lubishtani**

**Xhevdet Abazi**